

EC

MA NDRYSHE

EKO SHKOLLA

- REDUKTO - RIPËRDOR - RICIKLO -

EKO KLUBI

"UKSHIN HOTI"

1



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

CARITAS

Schweiz
Suisse
Svizzera
Svizra

YENI

YOUTH
ENVIRONMENTAL
IMPACT



Të dashur lexues,

EC ka filluar publikimin e buletineve mjedisore të eko-klubeve të shkollave të mesme nga Rajoni i Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës). Ky është buletini i parë informativ, i cili do të përmbajë mesazhe, intervista, ese, punime fotografi dhe shkrime të ndryshme mbi mjedisin dhe ndryshimet klimatike dhe njoftime mbi punën që po zhvillohet në këto tema nga eko-klubi i Shkollës së Mesme të Lartë "Ukshin Hoti" dhe OJQ EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "ECO School".

Ky projekt do t'i njohë me konceptin "Eko Shkolla" 12 shkollat e rajonit të Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës), përmes pilotimit të formave dhe metodologjisë për mbrojtjen e mjedisit me pjesëmarrje të gjerë të nxënësve dhe mësimitdhënësve.

Në kuadër të projektit ofrohet një model dhe metodologji që përdoret gjerësisht në vendet e zhvilluara, e cila po zgjerohet me shpejtësi edhe në vendet në zhvillim. Përvojat botërore tregojnë se shkolla ekologjike është një fenomen në rritje, e cila nxit të rinjtë të angazhohen në mjedisin e tyre duke u dhënë atyre mundësinë për ta mbrojtur atë në mënyre aktive.

Projekti po ashtu do të kontribuojë në Strategjinë e Mjedisit dhe Planin e Veprimit në Mjedis të Kosovës, duke rekomanduar zhvillimin e programeve për edukimin mjedisor në të gjitha nivelet (shkolla dhe universitete).

NATYRA DHE MJEDISI



Natyra është art i zotit, bekimi që vjen prej tij, frymëzimi i krijimit të qenies njerëzore. Pafajësia që na fali nëna natyrë ka ndryshuar me kalimin e kohës, mirësia në ato shpirtra të brishtë ka evoluar dashakeqësi.

Ajri që marrim frymë, uji që pimë, ushqimi që hamë dhe mijëra artikuj tjerë që përdoren janë nga natyra jonë. Njeriu po e përdor mjedisin tonë e po e trajton atë si pronë private duke ia humbur vlerat çdo ditë e më shumë. Ne po e shkatërrojmë këtë mjedis, po e prishim atmosferën.

Miliona fabrika të mëdha në tërë rruzullin tokësor. Tymi që po del nga këto fabrika po e shkatërron dhe më shumë mjedisin tonë, numri i automjeteve po rritet çdo ditë e më shumë. Ky tym po kthehet në sëmundje sidomos nëpër qytete.

Harrojmë që ajri është gjëja e parë që na duhet për të jetuar. Për aq kohë sa në kujdesemi për mjedisin, po të njëjtin kujdes marrim prej tij. Vjen një ditë kur rëndësia e mjedisit kuptohet më shumë se kurrë më parë. Mjedis mbrohet duke e dhënë secii kontributin e tij, duke e mbajtur pastër dhe duke u kujdesur për të. Të mbrosh mjedisin do të thotë të mbrosh jetën tënde dhe të pasardhësve.

“Ngjyrat janë buzëqeshja e natyrës, por natyra është buzëqeshja jonë...”

NJERIU DHE MJEDISI



Mjedisi është vendi në të cilin njeriu zhvillon aktivitete jetësore, por rëndësia e tij është universale. Është e vërtet se midis njeriut dhe mjedisit ekziston një raport varësie dhe “barazie” por fatkeqësisht ky raport nuk është parë kurrë nga ana e njeriut, sepse njeriu është munduar gjithmonë të shfrytëzojë të mirat që mjedisi ofron në favorin e tij, të marrë gjithcka e njëkohësisht të mos jap asgjë.

Panorama mjedisore formohet nga dy anë të medaljes, në njërin anë shohim zhvillimin e lartë ndërtesat e mbindërtuara, por tjetra është ajo që ndoshta përpiqemi t’a anashkalojmë sepse jemi të vetëdijshëm që jemi fajtorë të ndotjes së saj.

Njeriu është qenie komplekse. Ai i bën shkretëtirat të lulëzojnë dhe liqenet të vdesin. Toka po humbet dhe po degradohet, pyjet e zhveshura po mbeten si “kafshët pa lëkurë”. Të gjithë jetojmë në këtë mjedis, ushqehemi në këtë tokë dhe argëtohemi në këtë ambient.

Mbrojtja e tokës dhe e mjedisit nuk është çështje e një dite por e vazhdueshme. Rritja e përgjegjësisë individuale është celësi për të lëvizur nga ndërgjegjësimi drejt veprimit, gjë që do ta kthejë njeriun në ekuilibër me natyrën. Askush nuk duhet të harrojë, pavarësisht nga posti që mban, as toka nuk i përket një brezi, e as një mandat qeverisës, as njerëz të veshur me pushtet, e as edhe një ministrie të vetme.


Ne të gjithë kemi një rol për të luajtur, kemi përgjegjësi specifike për të arritur, nëse me të vërtet duam të thithim ajër të pastër, të pijmë ujë të freskët, të kemi rrugë të qeta, pejsazhe të mbrojtura, pra me një fjalë një vend të shëndetshëm për të jetuar. Toka është pasuria më e madhe kombëtare, është e brezave pa fund. Kjo tokë është shtëpia e vetme e të gjithë krijesave të gjalla, prandaj misioni më i shenjtë dhe më i çmueshëm i njeriut, do të ishte ruajtja e kësaj shtëpie të përbashkët dhe kujdesi maksimal i saj.

Ngjyrat janë buzëqeshja e natyrës, por natyra është buzëqeshja jonë. Mbill një lule për një të ardhme më të mirë nesër.




AKTIVITETET E EKO-KLUBIT:

TAKIMI MES EKO-KLUBIT DHE EC MA NDRYSHE





AKSION PASTRIMI NË OBORRIN E SHKOLLËS



EKO KLUBI "UKSHIN HOTI"

KRUSHË E MADHE, RAHOVEC, KOSOVË

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe
Rr. Fehmi Lladrovci Nr.94, Prizren & Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7,
Prishtinë
www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org
029 222 771 & 038 224 967

Ky buletin u realizua në kuadër të projektit "Ndikimi i Rinisë në Mjedis" - YENI, i cili bashkëfinancohet nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Caritas-i Zviceran, Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe implementohet nga OJQ EC Ma Ndryshe përmes projektit "ECO Schools".